

Kosovë

Ky është ish-luftëtari i UÇK-së që humbi jetën pas plagës me armë zjarri në Lipjan



Sinjali.com

06 Gusht 2026 10:40



Ky është 52-vjeçari Fatmir Olluri nga Dobraja e Madhe e Lipjanit i cili humbi jetën tragjikisht i cili një natë më parë ishte plagosur rëndë në kokë me armë zjarri.

Ai ishte dërguar fillimisht nga familjarët në Emergjencën e Lipjanit, pasi ishte gjetur i plagosur në kokë. Më pas, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, ishte transferuar për trajtim në QKUK.

Në vendin e ngjarjes kishin dalë të gjitha njësitë relevante policore, si dhe Prokurorja kujdestare për Krime të Rënda, e cila kishte urdhëruar inicimin e rastit si *"Vetëvrasje në tentativë"*. Gjatë ekzaminimit, arma që dyshohet se ishte përdorur në rast ishte sekuestruar.

**Lexo edhe****Ekskluzive | Humb betejën për jetën 52-vjeçari që u vetëplaqos me armë zjarri në Lipjan**

Pavarësisht përpjekjeve të mjekëve, Fatmir Olluri nuk ka arritur t'u mbijetojë plagëve dhe ka ndërruar jetë mbrëmjen e 5 gushtit, rreth orës 18:45, në Intensiven Qendrore të QKUK-së.

Me urdhër të Prokurores së Shtetit, trupi i pajetë është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) për obduksion, ndërsa rasti tashmë po hetohet si *"Hetim mbi vdekjen"*.

Tutje bëhet e ditur se Olluri ishte kthyer vullnetarisht nga Gjermania për t'iu bashkuar radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke dhënë kontributin e tij në luftën për liri.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Armë zjarri

Ish-ushtari

Lipjan

Vdekje

Të tjera:



Ekskluzive | Këta janë të dyshuarit për përleshjen me armë në Halabak të Podujevës – dy të...

Sinjalizime


Të shtëna me armë zjarri dhe shpërthime dëgjohe në aeroportin e kryeqytetit të Nigerisë

Botë


Të shtëna me armë në Prishtinë, plagoset një person

Siguri

Të shtëna me armë në Spaç të Mirditës, një i vdekur

Shqipëri


Policia e konfirmon raportimin e Sinjalit për të shtëna me armë ndaj autobusit në Malishevë

Sinjalizime

12 persona qëllohen me armë në një festival në SHBA, i dyshuari në arrati

Botë

Të shtëna me armë zjarri në Tiranë, policia ndalon 30-vjeçarin

Shqipëri

Ekskluzive | I dënuari për vrasje kapet me armë në brez në një kafiteri në Prizren

Ekskluzive

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumnë
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera